

Raport për rezultatet e konsultimeve publike

1. Titulli i draft aktit

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin””

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9270, datë 29.7.2004 “Për sistemin e adresave”, i ndryshuar është hartuar nga grupi i punës, i kryesuar nga zëvendësministri i Brendshëm, në zbatim të urdhrit nr. 139, datë 26.07.2022 të ministrit të Brendshëm “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, në bashkëpunim me Drejtorinë e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në Ministrinë e Brendshme, duke zhvilluar takimet në muajt gusht-dhjetor 2022, në Ministrinë e Brendshme.

Projektligji është dërguar për mendim në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrinë e Mbrojtjes, në muajin dhjetor 2022.

Konsultimi publik në RENJK për periudhën kohore në respektim të ligjit, nga data 21 dhjetor 2022 deri më datë 20 janar 2023. Si përfundim, kohëzgjatja e konsultimit në tërësi ka qenë nga data 26.07.2022 deri më 20.01.2023.

3. Metoda e konsultimit

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguroni informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë. Përfshini gjithashtu aktivitetet nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

Metodat e konsultimit të përdorura për **projektligjin** “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”” ishin dy:

1. Konsultimi elektronik, përmes Regjistrimit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet, RENJK për periudhë të paktën 20 ditë pune sipas ligjit, duke filluar nga data 21 dhjetor 2022 deri më 20 janar 2023.
2. Email.

4. Palët e interesit të përfshira

Palët e interesuara të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike gjatë procesit të hartimit, janë:

Grupi i punës në zbatim të urdhrin nr. 139, datë 26.07.2022 të ministrit të Brendshëm “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin” i kryesuar nga zëvendësministri i Brendshëm dhe i përbërë nga përfaqësues të:

- Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, AMVV;
- Drejtorisë së Përgjithshme të MZSH-së;
- Shërbimit të MZSH-së, në Bashkinë Tiranë;
- Shërbimit të MZSH-së, në Bashkinë Durrës;
- Shërbimit të MZSH-së, në Bashkinë Sarandë;
- Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive të Ministrisë së Brendshme (MB);
- Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në MB.

Gjithashtu, ka dhënë kontributin e saj edhe Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore Për Çështjet e Brendshme, përkatësisht:

Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në MB;

-Koordinatori për konsultimin në MB, për mbledhjen e komenteve nëpërmjet RENJK.

5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

Gruponi komentet/ propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;

Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;

Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

Çështja e adresuar <i>(psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)</i>	Komenti <i>(grumbulloni dhe përmbliidhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)</i>	Palët e interesuara <i>(renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)</i>	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi